



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE – MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE – MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE



DOGANA E KOSOVËS

CARINA KOSOVA- KOSOVO CUSTOMS

Kodi Doganor dhe I Akcizës është zhvilluar duke inkorporuar principet bazike për modernizimin e Administratës doganore prej WCO Konventës ndërkombëtare të njohur si konventa e Kjosës dhe Marrëveshja e përgjithshme për tarifa dhe tregti të njohur si GATT. Kodi I doganave dhe Akcizës krijon kushtet për zhvillimin të bizneseve dhe investimeve, gjithashtu ka për qëllim mbrojtjen e Ekonomisë në Republikën e Kosovës pa krijuar barrierë shtesë administrative.

- Kodi është I strukturuar në 8 kreu, 4 aneks dhe kapituj.

Kodi doganor dhe Akcizës është I përbërë prej 8 kreve dhe kapitujve në total 313 neneve

Kodi doganor është punuar nga zyra Ligjore e Doganës dhe është konsultuar me zyrën Ligjore të Brukselit, DG TAXUD, dhe të misionit CAFAO projekt i Komisionit Evropian.

Cilat janë ndryshimet ?

- Në të kaluarën fuqitë e oficerëve doganorë, të drejtat dhe obligimet e subjekteve kanë qenë të shpërndara neper shumë Rregullore të UNMIK – ut të sjella në kohe të ndryshme, tani shumica e tyre janë përmbledhur dhe janë inkorporuar në Kodin e Doganave dhe Akcizës që nënkupton edhe shndërrimin e tyre në Ligje të Republikës së Kosovës, gjithashtu paraqet një lehtësi me të madhe të respektimi dhe njohjen se tyre nga ana e palëve por edhe aplikimin me të drejte nga ana e oficerëve doganorë të tyre.

Organizimi

- Organizim dhe menaxhim më transparent në administratën doganore, gradimet, avancimet shkarkime janë të ndërtuara në atë mënyre që e orientojnë doganën në vetë-zhvillim.

Operatorët ekonomik

- Tani me dispozitat e reja te Kodit Doganor Agjensionet shpeditere për shërbime të operatorëve ekonomik në procedurën administrative doganore do te licencohen nga ana e Doganës kjo paraqet një zhvillim te ri ne kuptimin pozitive për subjektet e afarizmit te tregtisë se jashtme.
- Personat te cilët do te licencohen nga ana e doganës duhet ti plotësojnë kushtet e kërkuara me ligje te cilat janë: me se paku ta ketë te kryer shkollën e mesme, te ketë moshën mbi 18 vjeç, te ketë se paku 6 muaj përvojë ne fusha te doganës, ti ndjeke ligjëratat e organizuar nga Dogana dhe ne fund te kaloje me sukses provimin profesional te organizuar nga Dogana. Nëpërmjet kësaj synohet qe palë atë mos pësoje ne kundërvajtje për shkakë te mosnjohjes se dispozitave nga ane Përfaqësuesit te tij (shpeditërët) por edhe ne dogane te kemi deklarata unike doganore te plotësuara ne mënyre profesionale.

Arkivimi i Dokumenteve

- Te gjithë subjektet janë te obliguar qe Dokumentet doganore ti ruajnë për 5 vite për qellim te kontrollës nga dogana.

Lehtësirat

- Krijimi i lehtësirave për shfrytëzimin e procedurave me ndikim ekonomike dhe stimulim për subjektet e afarizmit te tregtisë se jashtme qe respektojnë dispozita ligjore doganore për shfrytëzim te procedurave te thjeshtësuara. Këtu duhet informuar te gjithë poseduesit e Autorizimeve te procedurave me ndikim Ekonomike duke përfshire edhe ata te Depove doganore se që nga data kur ka hyrë në fuqi Kodi Doganor dhe Akcizave në afat prej 6 muajve do të përfundoje, qe nënkupton që pas përfundimit te procedurës prej 6 muajve te gjithë mund të konkurrojnë për Autorizime te reja sipas dispozitave të këtij Kodi.

Dënimet

- Dënimet janë me te larta me dispozitat e këtij kodi se qe kane qene me dispozitat e kodit te vjetër Doganor Rregullorja e UNMIK – ut 2004/1, qëllimi I tyre nuk është dënues por edukues dhe janë ne përputhje me objektivat e Dokumentit te Verdhe te Komisionit Evropian për vitin 2009. Kemi dy procedura kundërvajtës

1. procedura e shkurte apo mandatore, dhe
2. procedura e rregullte.

Ne procedure te shkurte marrin pjesë te gjithë personat fizike vlera e mallit të cilëve nuk kalon 500€ të gjitha rastet e tjera shqyrtohen ne procedure të rregullte.

Veprat penale

- Kemi veprat penale doganore si vepra te veçanta doganore ku është bere riformulimi I tyre dhe është harmonizuar masa e dënimit me veprat e ngjashme te parapara me dispozitat e Kodit penal doganore qe ka qene një mos harmonizim me Kodin e vjetër doganor Rregullorja e UNMIK – ut 2004/1.

Hetimet

- Oficeret doganore hetojnë veprat penale doganore ku për qellim te veprave penale doganore te parapara me Kodin doganore dhe akizave konsiderohen polici gjyqësore sipas kuptimit te KPPK.

Anekset

- ❖ Ne Aneksin A kemi lirimit nga detyrimet doganore si per mallra po ashtu edhe per subjekt dhe procedurën e lirimit si te realizohet e drejta e lirimit.
- ❖ Aneksin B kemi lirimet e mallrave nga tatimi I Akcizës.
- ❖ Aneksin C kemi lirimet per subjekte
- ❖ Aneksi D lirimet sipas Aneksit V te Pakos se Marti Ahtisarit.